



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0661

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092), si dhe nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP-së 08. 09. 2023, në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani - Anëtar dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Harst Group” SH.P.K., kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të Komunës së Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi dhe përmisimi i Infrastrukturës së objekteve të KPSH-së” me numër të prokurimit 616-23-4220-5-1-1, me 18/12/2023, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “Harst Group” SH.P.K. me nr. 2023/0661, e datës 05/09/2023, kurse vendimi për anulim i Komunës së Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi dhe përmisimi i Infrastrukturës së objekteve të KPSH-së” me numër të prokurimit 616-23-4220-5-1-1 anulohet, dhe aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Harst Group” SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale-

Me 02.05.2023, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi dhe përmisimi i Infrastrukturës së objekteve të KPSH-së” me numër të prokurimit 616-23-4220-5-1-1.

Fillimisht AK Komuna e Prishtinës më dt. 02.08.2023, bënë publikimin e njoftimit mbi vendimin e AK, duke rekomanduar për kontratë OE NPT - ING SHPK; NNP EURO CONSTRUCTION.

OE "Harst Group" si palë e pakënaqur, paraqet kërkesë për ri-shqyrtim dhe AK i kalasifikon pretendimet ankimore si pjesërisht të bazuara dhe lëndën e kthen në ri-vlerësim.

Me 18.08.2023, AK ka publikuar njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit

OE "Harst Group" me datë 23.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër vendimi për anulim të aktivitetit të prokurimit nga ana e AK - Komuna e Prishtinës, me çrast është refuzuar kërkesa si e tillë është refuzuar.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues "Harst Group" me datën 05.09.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0661, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigjet e AK-së në kërkesën për rishqyrtim

- *Përgjigja e parë (I):* sipas të cilit parashtruesi pretendon që vendimi i datës 23.06.2023 lidhur me kërkesën për rishqyrtim të datës 17.06.2023 është nxjerrë jashtë afatit, duhet cekur se këtë pretendim parashtruesi ka pasur mundësi që ta parashtroj përmes ankesës në OSHP dhe jo tani në këtë fazë përmes kërkesës për rishqyrtim. Sidoqoftë përmes nenit 61 paragrafit 61.3 të RRPP është përcaktuar se "Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e parashtrimit të kërkesës, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informatave shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në nenin 60.2 të kësaj rregullore. Ky afat, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë". Në rastin konkret për shkak të ngarkesës së shtuar të punës në sektorin e prokurimit, Autoriteti Kontraktues ka vendosur të zgjatë afatin për vendosje edhe për tri (3) ditë shtesë dhe ka vendosur në ditën e pestë (5) pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim në përputhje të plotë me nenin 61 paragrafin 61.3 të RRPP sikurse është cituar më sipër. Rrjedhimisht ky pretendim ankimor është i pabazuar.
- *Përgjigja e dytë (II):* Bazuar në nenin 41.3 të RRPP është përcaktuar se "Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme : i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë". Nga administrimi i njoftimit mbi vendimin si provë në rastin konkret është gjetur se janë plotësuar të gjitha kriteret sipas nenit 41.3 të RRPP pasi që janë dorëzuar mbi 3 tenderë ndërsa dallimi në çmim mes të parit dhe të dytë është mbi 10% kurse dallimi në çmim mes të parit dhe mesatares së çmimeve të ofertuara është mbi 30%. Rrjedhimisht janë plotësuar kushtet ligjore që komisioni vlerësues të kërkoj nga

tenderuesi i rekomanduar që të sqaroj çmimet me të cilat ka ofertuar si çmime që mund të rezultojnë si jonormalisht të ulëta. Mirëpo komisioni nuk ka vepruar në këtë mënyrë dhe për këtë arsye nuk ka respektuar nenin 61 të LPP përkatësisht nenin 41 të RRPP. Në këtë mënyrë është gjetur se ky pretendim i parashtruesit është pretendim i bazuar.

- *Përgjigja e tretë (III):* paraprakisht duhet sqaruar se në formularin e paramasës që është publikuar në sistemin e-prokurimi në rubrikën me numër 4.6 dhe 4.7 nuk është përcaktuar fare sasia për të cilin tenderuesit duhet të ofertojnë çmimet e tyre. Sa i përket pretendimit ankimor, në ofertën e tenderuesit të rekomanduar është gjetur se çmimet e ofertuara për këto kategori janë përcaktuar për një (1) sasi. Megjithatë pretendimi i parashtruesit është pjesërisht i bazuar pasi që paramasa e hartuar si e tillë nga njësia kërkuese gabimisht nuk ka përcaktuar sasinë për të cilin tenderuesit duhet të ofertojnë çmimet e tyre. Pra parimisht gabimi qëndron në paramasë dhe jo në çmimet që kanë ofertuar jo vetëm tenderuesi i rekomanduar por edhe tenderuesit e tjerë. Kjo pasi që nuk ka mundësi që të ofrohet çmimi për diçka që nuk i dihet sasia. Kuptohet se çmimi për një punë ose produkt përcaktohet në bazë të sasisë së kërkuar. Në rastin konkret në paramasë njësia kërkuese gabimisht nuk e ka përcaktuar fare sasinë përkatëse. Me rastin e rivlerësimit komisioni duhet të konfirmoj nëse ekzistojnë gabime në paramasën e publikuar në sistemin e-prokurimi lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Nëse komisioni rivlerësues e konfirmon se ekzistojnë gabimet në paramasë të potencuara më sipër, atëherë komisioni rivlerësues duhet të shqyrtoj nëse këto gabime përbëjnë arsye për anulimin e aktivitetit të prokurimit me qëllimin që të përmisohen gabimet e evidentuara në paramasë dhe të rishpalljes më pastaj. Me këtë rast komisioni për rivlerësim duhet të ketë parasysh nenin 62 paragrafin 1 nënparagrafin 1 të LPP ku përcaktohet se Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës nëse ka ndodhur "një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes njëamendamenti ligjor të kushteve të prokurimit.". Po ashtu duhet cituar edhe nenin 43 paragrafin 43.5 nënparagrafët i) të RRPP ku përcaktohet se procedura e prokurimit duhet të anulohet pas hapjes së ofertave nëse "një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi". Në rastin konkret shkeljet e ligjit të cilave ju referohen dispozitat e cituara më sipër mund të jenë të ndërlidhura me nenin 27 dhe 28 lidhur me nenin 1, 6 dhe 7 të LPP si dhe nenin 10 paragrafin 10.1 nënparagrafin b lidhur me nenin 11 paragrafin 11.1 nënparagrafin f të RRPP. Konkretisht gabimet e evidentuara në paramasë si të tilla mund të bëjnë që paramasa të mos jetë në përputhje me standardet e përcaktuara nga LPP dhe RRPP pasi që në mungesë të sasive të përcaktuara në rubrikën 4.6 dhe 4.7 mund të pamundësojnë që tenderuesit të ofertojnë me çmime adekuate dhe rrjedhimisht e pamundësojnë që vlerësimi i tenderëve të bëhet i drejtë dhe në përputhje me parimet për mos diskriminim/favorizim, ekonomikitet dhe efikasitet. Sidoqoftë, për arsyet e elaboruara më sipër është gjetur se ky pretendim i parashtruesit është pjesërisht i bazuar. Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij të dytë dhe pjesërisht pretendimin e tij të tretë por jo edhe pretendimin e tij të parë dhe pretendimet tjera ankimore. Për këto arsye është miratuar si e bazuar pjesërisht kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Harst Group" SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

- *Pretendimi Grupi OE "Harst Group" shpk & Niva Construction Shpk & Ekotermika Shpk,* përmes kërkesës për ri shqyrtim te datës 17.06.2023 ka kërkuar, ri vlerësim te ofertave dhe kemi ngritur me dhjetëra pretendime ankimore, të cilat AK-së nuk i ka shqyrtuar fare, kurse në kërkesën e datës 06.08.2023 , përveç që nuk trajton pretendimet tona, AK nxjerr vendim

pas më shumë se 10 dite për anulim të aktivitetit me arsyetime të cilat nuk kanë bazë ligjore. Paragrafi 6 i nenit, 108/A, të LPP-se, përcakton: "Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë". Pra AK nuk nxjerrë vendim mbi kërkesën tonë për rishqyrtim, pra nuk trajton fare pretendimet tona por nxjerrë vendim për anulim të aktivitetit. Grupi i Operatorëve Ekonomik "Harst Group" shpk & Niva Construction Shpk & Ekotermika Shpk, përmes kërkesës për ri shqyrtim të datës 17.06.2023 ka kërkuar, ri vlerësim të ofertave dhe ka ngritur me dhjetëra pretendime ankimore, ndërsa AK – Komuna Prishtine, asnjërin nga pretendimet tona nuk e ka trajtuar, ndërsa në kërkesën e datës 06.08.2023, përveç që nuk ka trajtuar pretendimet tona, fare nuk nxjerrë vendim ndaj kërkesës për ri shqyrtim, përkundrazi pas më shumë se 10 ditësh, nxjerrin njoftim mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit dhe e anulojnë në tërësi me arsyetim i cili nuk gjen bazë ligjore. Paragrafi 8, i nenit 108/A, të LPP-se, përcakton rastet e refuzimit të kërkesës për ri shqyrtim, përkatësisht pika 8.4, obligon AK të nxjerrin vendim dhe të arsyetoj çdo pretendim ankimor "autoriteti kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi".

- *Pretendimi* Arsyetimi i anulimit të aktivitetit të prokurimit në këtë fazë të procedurës dhe pas tre vlerësimeve se "Ekzistojnë gabime në paramasën e publikuar në sistemin e-prokurimi lidhur me këtë aktivitet të prokurimit në rubrikën 4.6 dhe 4.7...", dhe dispozitat që i referohet AK ndërlidhen me çështjen e anulimit të procedurës para pranimit të ofertave, dhe jo pas hapjes, dhe ri vlerësimit të trefishtë të ofertave. Nenin 62, paragrafi 2, pika 2.2 që përcakton mundësinë dhe periudhën kohore kur AK mund të anuloj aktivitetin e prokurimit: "para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve". Për më tepër përgjatë vlerësimit të parë vet AK – Komuna Prishtinë për këtë çështje ka potencuar se janë pozicionet 4.6 dhe 4.7, të paramasës janë parëndësishme dhe si të tilla mbesin, meqë nuk do të realizohen fare. Poashtu këto dy pozicione e kanë përshkrimin dhe kanë njësinë dhe për të njëjtat në kemi ofertuar çmimin për njësi. Nenin 97, i rregullores për prokurim publik nr 001/2022 paragrafi 1, përcakton shkeljet e rëndësive në prokurim publik dhe verimet e AK-së, janë tipike dhe tregojnë për konsum të shkeljeve sipas pikave të poshtë përcaktuara: e. Mos respektimi i rregullave për trajtimin e kërkesave për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues. k. Anulimi i aktivitetit të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik. o. Nëse ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për sjellje të gabuar apo jo profesionale të një zyrtari të prokurimit ndaj operatori ekonomik apo ndaj cilit do person gjatë ushtrimit të procedurës së prokurimit. p. Mosrespektimi i afateve kohore në nxjerrjen e vendimit në kërkesa për rishqyrtim dhe afateve kohore në rast të ankesave në OSHP. 1. Pika (e) tregon faktin e pa kontestueshëm se në kërkesat për ri shqyrtim të datave 17.06.2023 dhe të asaj të datës 06.07.2023, pretendimet tona nuk janë trajtuar dhe afatet ligjore nuk janë respektuar, 2. Pika (k) anulimi i aktivitetit pas hapjes dhe vlerësimit të ofertave, përkatësisht pas formimit të tretë të komisionit vlerësues të ofertave shkel nenin 62, të konfirmuar edhe me vendim të organit ligjor zbatues – OSHP. 3. Pika (o), tregon faktin se ndaj nesh si OE, përkundër faktit se kemi ofertuar si të përgjegjshëm pohimet dhe argumentet tona nuk prezantohen, nuk trajtohen dhe anashkalohen nga zyrtarët përgjegjës të prokurimit. 4. Pika (p), është fakt i pa mohueshëm që ndaj kërkesave tona për ri shqyrtim përveç se nuk janë

trajtuar pretendimet dhe nuk është konstatuar pa përgjegjshmëria e OE-ve të argumentuara me prova shkresore, nuk nxjerret vendim fare nga ju si AK, por nxjerrët vendim mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit. Fakti i çuditshëm dhe mos konsistenca, përkatësisht tendenca dhe shkelja e parimeve bazike në prokurim publik argumentohet me faktin se AK-së, pikërisht për të njëjtën çështje edhe paraprakisht, ka vepruar ngjashëm pas hapjes së ofertave, ka tentuar ta anulojë aktivitetin tjetër të prokurimit, atë me nr. 616-22-11826-5-2-1, me arsyetimin se ka hasur në pozicione të pa definuara, megjithatë OSHP, sipas vendimit ka konstatuar se veprimet e AK-së juaja janë kundërligjore dhe lënda është kthyer në rivlerësim. PROVE Vendimi nr. 34/23, i datës 03.05.2023.

- *Pretendimi i tretë (III):* Arsyetimi i anulimit lidhur me gabimet e potencuar nga AK, në paramasë dhe pohimi se mund të pamundësojnë që tenderuesit të ofertojnë me çmime adekuate dhe pamundësimi i vlerësimit të drejte në këtë fazë të prokurimit është i kundërligjshëm dhe kundërtshënës me vlerësimet paraprake të AK dhe përveç që shkelin dispozitat ligjore mund të konsiderohen si me qëllime të caktuara. Nenit 27, të LPP-se përkatësisht nenit 17, paragrafi 12, të RRPP-se, ku përcaktohet: - “Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata shtaruese shtesë. Veçanërisht, autoriteti kontraktues duhet të ketë parasysh, kur përgatitet dosja e tenderit, që mos të ketë komunikime, diskutime ose negociime në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve...”. Për aplikim jo të drejte dhe vlerësim kundërligjor të ofertuesve të caktuara, ndërhyrje në paramasë, në format standarde, nuk mund të pësojnë të gjithë operatorët ekonomik. Neni 59, i Ligjit për prokurim publik paragrafi 1, përcakton përgjegjësit individuale të vlerësimit të çdo njërit nga anëtarët e komisionit vlerësues apo edhe ri vlerësues, ndërsa paragrafi 4 i të njëjtit nen përcakton që AK, do ta konsideroi një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e përcaktuara në njoftim për kontratë dhe në dosje të tenderit. Ndaj OE-ve pjesëmarrës në këtë procedurë të prokurimit të cilët në këtë fazë janë palë pa interes në si OE, kemi prezantuar prova materiale, përmes të cilave ligjërisht duhet skualifikuar dhe eliminuar Ofertuesit tjerë, që nga ndërhyrjet në paramasë dhe paralogari, mos plotësimin e kërkesave kualifikuese dhe çështje tjera të cilat në si OE i kemi prezantuar në kërkesat për ri shqyrtim të datës 17.06.2023 dhe asaj të datës 06.08.2023. Në vazhdim pretendimet ankimore për ofertuesit.
- *Pretendimi i katërt (IV):* Duke u bazuar në kërkesën për rishqyrtim të datës 17.06.2023 dhe 07.08.2023. Grupi i OE-ve “NBT-ING & NNP Euro Construction” përveç që është palë pa interes i njëjti është i papërgjegjshëm duke u bazuar në kërkesat e DT-së. 4.1- AK në kërkesën për rishqyrtim të datës 17.06.2023 ka aprovuar si të bazuar pikë për çmime jonormalisht të ulët për GOE në fjalë, dhe pas rivlerësimit të njëjtit nuk kanë kërkuar asnjë sqarime për çmime dhe është paradoks se si AK-së është bindur me këto çmime dhe si i ka trajtuara si të mirëqena. Të gjitha këto çmime dhe pozicione është e pa mundur që të realizohen me këtë kosto po ashtu është e pamundur që të jepet shpjegim dhe argument për furnizim me çmime të tilla. Dispozita ligjore dhe nënligjore, përfshire dhe interpretimet e KRPP-se, që për kontratat e tipit kornize ligjërisht çdo AK, e obligon që për çdo pozicion të konsumohet minimumi 70 % i vlerës se pozicionit dhe jo konsumi i 70 % të vlerës se

përgjithshme të kontratës. Neni 56 par 11, i RRUOPP-se, përcakton “ ... Autoriteti Kontraktues merr përsipër që të porositë, pranoj dhe paguaj sasinë totale prej së paku shtatëdhjetë përqind (70%) nga sasia indikative e vendosur në dosjen e tenderit përkatësisht në kontrate, prandaj autoritetet kontraktuese duhet të kenë parasysh këtë fakt sidomos në fazën e përgatitjes së sasive indikative në dosje të tenderit e cila në secilin rast nuk guxon të ndryshojë në plus/minus 30 % e vlerës indikative”. Kjo çështje lidhur me pozicione dhe çmime te tilla tani me përmes shumë vendimeve te OSHP-se është gjykuar dhe vendosur ndryshe Ndërsa neni 41.6, i Rregullores për PP, nr. 001/2022, përcakton: “Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja...”. Është i pamundur zbërthimi i detajuar i pozicioneve të tilla dhe argumentimi i këtyre pozicioneve të cilat përveç se janë çmime jo normalisht të ulëta të njëjtat janë çmime abuzive, përkatësisht lidhja eventuale e kontratës me këto çmime do duhej te raportohej dhe të auditohet. 4.2-AK nuk ka trajtuar fare çështjen e ndërhyrjes në paramasë pasi që GOE në fjalë ka ndërhyrë në paramasë dhe paralogari, dhe të njëjtin pretendim AK-së nuk e ka trajtuar, rrjedhimisht keni shkelur paragrafin 8.4 te nenit 108/A, te LPP-se. Behet fjale për ndërhyrje ne formularin e përshkrimit të çmimit, me konkretisht ne pozicionin 4.6 dhe 4.7 te punëve te Suvatimit dhe ngjyrosjes ku OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka shtuar sasinë dhe ka përshkruar vlerën 1. Neni 44.3 te Rregullores për prokurim publik përcakton: “Deklaratat duhet të përmbajnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde. Por kompania që bën deklaratën ka të drejtë që të vendos logon, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes „header” apo kudo tjetër në dokumentet standarde”. Për ndërhyrje ne formular standard, edhe KRPP tani me ka nxjerr disa opinione – interpretime, ku një gjë te tille e konsideron si te kundërligjshme, madje edhe vet OSHP, sipas vendimeve ka gjykuar ndryshe nga AK – Komuna Prishtine.

- *Pretendimi i pestë (V):* Grupi OE EngGroup Sh.p.k .& Alping Sh.p.k. përveç që është palë pa interes të njëjtit janë të papërgjegjshëm duke u bazuar në kërkesat në DT. 5.1- Konsiderojmë që Grupi OE EngGroup Sh.p.k. & Alping Sh.p.k. është i papërgjegjshëm për arsye që planin dinamik të prezantuar nuk është punuar sipas kërkesës pasi që kontrata është kornizë dhe nuk ka të prezantuar projekt specifik, atëherë ndarja e periudhave dhe organizimi i punimeve nga OE në fjalë është i gabuar dhe i si i tillë plani dinamik do të duhej të ishte i papranueshëm për AK-së, pasi që ka lënë hapësira të evidentuar që nuk do të punohet me ditë të tëra, që është në kundërshtim me kërkesën e DT . 5.2- Po ashtu i njëjti OE, tek punët e muratimeve ka ofertuar me çmime për pozicione te caktuara te cilat janë çmime jo normalisht te ulëta dhe AK-së, nuk ka ndërmarr asnjë veprim për ti sqaruar dhe argumentuar të njëjtat pozicione. Pompa termike është ofertuar nga GOE me çmim qesharak 250 €, kur ne kemi të freskët çështjen e subvencionimit të qeverisë për produkte të tilla dhe vlerë prej mbi 1500 euro për pompa termike dhe kanë qenë bashkëfinancim i qeverisë. Çmimi i këtyre pompa në treg varësisht nga prodhuesi dhe kapaciteti është 2500-6500 euro për njësinë matëse te përcaktuar nga ju si AK - “copë”. 5.3- I njëjti grup i OE-ve, nuk i plotëson as kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional sa i përket stafit të kërkuar dhe të certifikuar: - Nuk është prezantuar suvatues sipas kërkesës se AK-së, -Nuk është prezantuar Fasader, -Mungon tekniku, nuk

është sipas kërkesë në DT. -Po ashtu te njëjtit kanë prezantuar fotografi të pajisjeve në emër te subjekteve tjera dhe nuk kane prezantuar marrëveshje për shfrytëzim të të njëjtave pajisje. Rrjedhimisht oferta e te njëjtit grup do duhej te konsiderohej si ofertë e pa përgjegjshme, rrjedhimisht vlerësimi i ofertave është realizuar ne kundërshtim me nenin 59, te LPP-se.

- *Pretendimi i gjashtë (VI):* OE “Olti Trasing” përveç që është palë pa interes të njëjtit janë të papërgjegjshëm duke u bazuar në kërkesat në DT. 6.1- OE tjetër pjesëmarrës “Olti Trasing”, ngjashëm ka ndërhyre ne dokumente standarde te miratuara nga KRPP, përkatësisht ka përshkruar sasinë tek pozicioni nr. 4.6 dhe 4.7 , te punëve te Suvatimit dhe ngjyrosjes, ku një gjë e tille është e ndaluar dhe kundërligjore. 6.2- I njëjti OE , ne oferte ka ofruar çmime abuzive, të ulëta dhe manipulative, në vazhdim do ju bashkëngjisim disa prej pozicioneve ku janë çmime te ekzagjeruar, të ulëta dhe të pakuptimta, rrjedhimisht çmimet e tilla të pranohen si te mirëqena nga AK, është absurditet dhe jo konsistent ne procedurat paraprake te realizuara nga AK, ku neve si kompani posedojmë fakte përmes te cilave AK-Komuna e Prishtinës, ka eliminuar oferta me çmime te tilla madje edhe me të larta. Çmimet për hapësirat me rrezatim jonizues janë çmime jo normalisht të ulëta dhe abuzive, ku AK nuk ka ndërmarre asnjë veprimi siç obligohet me dispozitat e nenit 61, te LPP-se. Si shumë çmime tjera, çmimet e ofertuar të OE kanë dallim të madh për produkte që janë me çmime të përafërta dhe kanë specifika të ngjashme për instalimin e tyre dhe nuk do të duhet të kishin këtë dallim por konsiderojmë që OE ka vendosur çmime shumë të ulëta në disa pozicione ndoshta për qëllim mos realizimin e tyre. Pra flakëdhësi 150-200 që ka vendosur çmimin 10 euro, kurse për flakëdhësin 200-250 ka vendosur çmim 700 euro, rrjedhimisht këto çmime janë tipike abuzive, dhe për qëllim kane keqpërdorimin e parasë publike. 6.3-, OE i njëjte, është i papërgjegjshëm edhe për faktin se planin dinamik të prezantuar nuk është ofruar sipas kërkesës se përcaktuar ne dosje te tenderit, pasi që kontrata është kornizë dhe nuk ka të prezantuar projekt specifik, nuk është bere ndarja periudhave kohore, angazhimi i stafit dhe organizimi i punimeve nga OE në fjalë është i gabuar dhe i si i tillë plani dinamik do të duhej të ishte i papranueshëm për AK-së, pasi që ka lënë hapësira të evidentuar që nuk do të punohet me ditë të tëra. 6.4-, Në dosje të DT tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional i njëjti OE nuk ka prezantuar. -Teknik te ndërtimtarisë nuk është i profilit të kërkuar në DT - Saldues i certifikuar sipas kërkesave në DT Prandaj AK, ofertën e te njëjtit OE, detyrimisht ka qenë dashur ta eliminoj si të pa përgjegjshme ne kuptim te nenit 59, të LPP-se. OE “Limit project” Shpk përveç që është palë pa interes të njëjtit janë të papërgjegjshëm duke u bazuar në kërkesat në DT. 7.1- Sa i përket kërkesës se DT-se “Një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (drejtimi Konstruktiv) me 10 vite përvojë pune pas diplomimit, i trajnuar për mbrojtje dhe siguri në punë dhe mbrojtje nga zjarri dhe ndërhyrjes ndaj emergjencave. I certifikuar për efecientë te energjisë. Të jetë menaxher i projektit. Për këtë pozitë i njëjti OE, nuk ka prezantuar kurrfarë dëshmie përmes te cilës vërtetohet certifikimi për mbrojtje dhe siguri ne pune, mbrojtje nga zjarri dhe ndërhyrje – emergjence. Për me tepër nuk është prezantuar as vendim mbi caktimin – emërimin e menaxherit dhe CV. 7.2-, E njëjta kompani planin dinamik, te aplikuar tek kërkesat e kualifikimit nuk e ka prezantuar fare. 7.3- OE ka prezantuar çmime për pozicione te caktuara dhe poshtë evidentuara si jo normalisht te ulëta epo edhe abuzive 7.3-Tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional lidhur me stafin e kualifikuar dhe te certifikuar i njëjti OE nuk ka prezantuar teknik te ndërtimtarisë, rrjedhimisht nuk përcaktohet kualifikimi shkollor. Po ashtu, tek kërkesa 5 është kërkuar: Një inxhinier i makinerisë me minimum 10 vite përvojë pune–drejtimi termooenergjetike dhe termoteknike, ku OE nuk ka prezantuar kurrë far dëshmie për te mbuluar këtë kërkesë te kualifikimit. Ngjashëm është vepruar edhe për inxhinierin e diplomuar te ndërtimtarisë (drejtimi Konstruktiv) me 10 vite përvojë pune pas diplomimit, i

trajnuar për mbrojtje dhe siguri në punë dhe mbrojtje nga zjarri dhe ndërhyrjes ndaj emergjencave. I certifikuar për eficientë të energjisë dhe të jetë menaxher I projektit. Për këtë pozitë nuk është prezantuar asnjë dëshmi përmes të cilës vërtetohen certifikimi për mbrojtje dhe siguri në punë , mbrojtje nga zjarri dhe certifikim për ndërhyrje prej emergjencave , po ashtu i mungon edhe certifikimi për eficiencë dhe vendimi për emërimin menaxher. Për stafin e kualifikuar nuk janë prezantuar dëshmi sipas kërkesë apo kualifikimit inxhinier i diplomuar por është dorëzuar kualifikimi bachelor. 7.4- Nuk është prezantuar asnjë dëshmi për saldues të certifikuar. 7.5- Edhe tek pajisjet teknike, të kërkuara në dosje të tenderit: - Pajisje për Gërryerjen e gletit - Trapan për demolimin e betonit - Makinë për ngjyrosje, është prezantuar marrëveshja por jo edhe dëshmitë dokumentare për pajisje.

Eksperti shqyrtues me datën 22.09.2023 ka dorëzuar raportin e ekspertizës duke rekomanduar që: *“ankesa të aprovohet si e bazuar, të anulohet vendimi i AK-se për anulim dhe lënda të kthehet në rivlerësim”*. Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të gjitha palët procedurale. AK lidhur me mendimin e ekspertit ka deklaruar se nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është deklaruar për mendimin dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Me tutje, lidhur me pretendimet e OE “Harst Group” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0661 ka vlerësuar si në vijim:

- *Pretendimi i parë (I):* Në këtë rast bazuar në kompetencat e mia si Ekspert për të shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit mund të rekomandoj se ky aktivitet i prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim për këto arsye: 1. Autoriteti kontraktues ka vërejtur se ka gabime në fillim dhe me datën 02.08.2023 ka dërguar te operatorët ekonomik se ka lëshuar një gabim teknik të pozicionet 4.6 dhe 4.7. Ndërsa Raporti i komisionit rivlerësues pikërisht, në njërin nga këto pozicione i përcakton që kanë ndikuar në gabimet në paramasë, paksa paradoksale. 2. Për këto çështje autoriteti i njëjtë kontraktues ka pasur një vendim nga ana e Panelit Shqyrtues Nr. 34/23 të datës 03.05.2023, andaj është dashur të jetë më vigjilente në rastet tjera, pra e ka përsëritur prapë gabimin. 3. Autoriteti kontraktues në njoftimin për anulimin e aktivitetit të këtij prokurimi, ka pranuar raportin e komisionit rivlerësues me datën 17.08.2023, ndërsa në vendimin për anulimin e këtij procesi të prokurimit data figuron 18.07.2023, dhe 4. Përgjigjet për të gjitha rastet mjaft bindëse nga ana e ankuesit, në mënyrë detale i ka sqaruar në ankesë, ku për mua si ekspert më kanë bindur që të ndikojnë në rekomandimin përfundimtar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “Harst Group” SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE janë të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet aprovohet si e bazuar. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim. Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP, dhe konstaton se AK nuk ka dhënë prova bindës se ky aktivitet i prokurimit të anulohet dhe këtë nuk e ka bërë as përmes përgjigjes së kërkesës për ri-shqyrtim.

Paneli Shqyrtues konsideron se rrjedha e aktivitetit të prokurimit, karakterizohet në përputhje me dispozitat ligjore, të cilat në raport me qëllimin e synuar të këtij aktiviteti të prokurimit, nga pikëpamja e këtij Paneli, janë implementuar me kujdesin e shtuar dhe në mënyrë profesionale.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - HARST Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: